



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 shkurt 2015
Nr. ref.:RK 767/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI147/14

Parashtrues

Avni Ejupi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 81/2014,
të 16 korrikut 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Avni Ejupi nga komuna e Ferizajt.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 81/14, i 16 korrikut 2014, me të cilin revizioni i parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Ac. Nr. 4792/12 i 13 janarit 2014) ishte refuzuar si i pabazuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Në kërkesën e tij parashtruesi nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë cenuar, dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështet kërkesën e tij, mirëpo kërkon vlerësimin e çështjes së afatshmërisë së padisë së tij.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 nëntor 2014, me Vendimin GJR. KI147/14, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI147/14, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 14 nëntor 2014, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, duke i kërkuar plotësimin e kërkesës së tij me dokumente shtesë.
8. Më 3 dhjetor 2014, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.
9. Më 18 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentet shtesë.
10. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Duke filluar nga 1 korriku 2000 e deri më 31 dhjetor 2001, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar si referent për punë të përgjithshme juridike në

Drejtorinë Komunale për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi).

12. Më 8 janar 2002, punëdhënësi nxori Aktvendim (02 nr. 77) për mos vazhdimin e kontratës me arsyetim se parashtruesi kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.
13. Më 8 janar 2002, ndaj aktvendimit të lartcekur, parashtruesi ka paraqitur ankesë te organet e punëdhënësit.
14. Më 22 shkurt 2002, si rezultat i mospërgjigjes ndaj ankesës nga ana e punëdhënësit brenda afatit të caktuar ligjor, parashtruesi ka paraqitur urgjencë për heshtje administrative.
15. Më 10 prill 2002, Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Ferizajt, si përgjigje ndaj urgjencës së parashtruar nga parashtruesi e njofton atë se nuk ka elemente bindëse për ndryshimin e aktvendimit të punëdhënësit për mosvazhdimin e kontratës.
16. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 prill 2002, parashtruesi ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj për kthimin në vendin e tij të punës.
17. Më 29 dhjetor 2006, derisa padia e parashtruesit ishte akoma në procedurë e sipër pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj, parashtruesi ka paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK).
18. Më 31 janar 2007, KPMK, me Vendimin A. nr. 02/195/2006, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetimin se parashtruesi kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, për të cilën nuk ishte vendosur akoma.
19. Më 13 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendimi, C. Nr. 66/09) padinë e parashtruesit e hodhi poshtë si të paafatshme.
20. Gjykata Komunale në Ferizaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës së Bashkuar, të cilin ligj e konsideroi si të aplikueshëm në këtë rast, konstatoi se, pasi që punëdhënësi ndaj ankesës së parashtruesit të 8 janarit 2002 nuk kishte nxjerrë vendim në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, parashtruesi padinë e tij në gjykatë është dashur ta parashtrojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas skadimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga paraqitja e ankesës së tij në organet e punëdhënësit. Si rrjedhojë, Gjykata Komunale në Ferizaj konstatoi se parashtruesi padinë e tij në gjykatë e kishte paraqitur me vonesë prej 28 (njëzet e tetë) ditësh.
21. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, parashtruesi ka paraqitur ankesë.
22. Më 13 janar 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi, AC. nr. 4792/12) ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj (C. Nr. 66/09, të 13 nëntorit 2012).

23. Më 18 shkurt 2014, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit parashtruesi ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.
24. Më 16 korrik 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi, Rev. Nr. 81/2014) revizionin e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar.
25. Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi se padia e parashtruesit në gjykatën e shkallës së parë ishte e paafatshme, si dhe konstatoi se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kishin zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të vlerësojë çështjen e afatshmërisë së padisë së tij pranë gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim.
27. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë cenuar dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështet kërkesën e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, që parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që kërkesën e tij ta qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akt konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

30. Gjykata, gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) Gjykata do të deklaroj një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

31. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të vlerësojë çështjen e afatshmërisë së padisë së tij pranë gjykatës së shkallës së parë, dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim.
32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur kryesisht me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta.

Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.

33. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përfshirë edhe nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
34. Gjykata, po ashtu vëren se parashtruesi në kërkesë nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e tij.
35. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
36. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse përfundimi i Gjykatës Supreme për "Ligjin e zbatueshëm në atë kohë", në rastin e tij ka shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me Kushtetutë, dhe as që ka pretenduar ndonjë padrejtësi dhe arbitraritet në procedurë.
37. Përveç kësaj, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
38. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
39. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 9 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani